



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 80/1 prot.

Tiranë më 5.2.2018

**VENDIM**

Nr. 05, datë 5 / 2 /2018

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankimin nr. 1500 Prot., datë 16.11.2017, kundër Autoritetit Publik “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion si më poshtë:

1. Numrin total të subjekteve të rivlerësimit për të cilat ILDKPKI ka përfunduar procesin e kontrolleve të deklaratave të pasurisë pas ngritjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelit;
2. Nga totali i kontrolleve të përfunduara nga ILDKPKI, cili është numri i subjekteve të rivlerësimit që sipas vlerësimit të këtij institucioni ka rezultuar se:
  - a) Kanë deklaruar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare dhe nuk gjenden në situatë konflikt interesi;
  - b) Kanë patur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Deri në ç’ nivele shkon pasuria që nuk justifikohet nga këto burime? Sa janë rastet kur ajo e tejkalon dyfishin e pasurisë së justifikuar nga subjekti si të ligjshme;
  - c) Kanë kryer fshehje të pasurisë? Nëse kanë rezultuar shkelje të tilla, të ç’ natyre kanë qenë këto fshehje;

- d) *Kanë kryer deklarin të rremë? Nëse kanë rezultuar shkelje të tilla, ku kanë konsistuar këto deklarime të rreme;*
- e) *Gjenden në situatën e konfliktit të interesit, i ç'natyre është ky konflikt?*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 3312/1 Prot., datë 05.09.2017 ka vënë në dispozicion të kërkuarit informacionin vetëm për pikën e parë të kërkesës. Kërkesa për informacion është përsëritur me shkresën nr. 739 Prot., datë 3.10.2017, dhe Autoriteti Publik i ka kthyer sërish përgjigje me shkresën nr. 3312/3Prot., datë 19.10.2017 duke sqaruar se, informacioni i kërkuar lidhet me vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelimit, struktura këto të ngritura për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv si dhe në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin shprehimisht thuhet se *"...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve"*, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore e cila u zhvillua me datë 22.01.2018.

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, i qëndruan argumenteve të dhëna në shkresat kthim përgjigje, duke sqaruar më tej se informacioni i kërkuar nuk disponohet dhe nuk është i prodhuar nga ky i fundit në kuadër të veprimtarisë së tij funksionale, por është një informacion i ri që kërkohet të krijohet sipas kërkesës së ankuesit.

Nga ana e tij, ankuesi, sa i përket argumentit të Autoritetit Publik se informacioni i kërkuar lidhet me vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelimit, arsyeton se kërkesa për informim është kryesisht me natyrë statistikore dhe është bazuar në kompetencat ligjore të Autoritetit Publik dhe ky i fundit ka shmangur dhënien e informacionit duke ia kaluar këtë funksion organeve të rivlerësimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në shqyrtimin e çështjes, gjejnë zbatim dispozitat e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu gjejnë zbatim në shqyrtimin e kësaj ankese Vendimet nr. 02 datë 18.01.2017 dhe 78 datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik se informacioni i kërkuar është i destinuar për një autoritet tjetër dhe nuk është informacion i prodhuar për llogari të tij, Komisioneri vlerëson se Neni D i Aneksit të Kushtetutës përcakton dhe njeh shprehimisht rolin e Autoritetit Publik në kuadër të procesit të rivlerësimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Pra, nisur edhe nga detyrat që Kushtetuta i ka atribuar Autoritetit Publik në



kuadër të procesit të rivlerësimit (të cilat qëndrojnë brenda natyrës së aktivitetit të ushtruar sipas ligjit material nga Autoriteti Publik) rezulton që vetë ky nen i Kushtetutës konfirmon statusin e Autoritetit Publik edhe në kuptim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Kjo është edhe fryma e paragrafit 40 të Vendimit nr. 02 datë 18.01.2017 si dhe paragrafëve 37, 38 dhe 39 të Vendimit nr. 78 datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese, të cilat i veshin Autoritetit Publik si dhe autoriteteve të tjera ekzistuese të përfshira në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rol ndihmës, në raport me institucionet e rivlerësimit të krijuara posaçërisht për këtë proces, si dhe i njohin këtyre institucioneve të drejtën për të kryer hetime të mëtejshme në kuadër të vendimmarjes përfundimtare. Ky cilësim duhet parë në kontekstin e arsytimit të Gjykatës Kushtetuese të cilës i është dashur të shprehet për ruajtjen e ndarjes së pushteteve dhe pavarësinë e institucioneve të procesit të rivlerësimit, si dhe kontrollin e pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin e organeve ekzistuese (ku bën pjesë dhe Autoriteti Publik) në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe jo në sensin përjashtues për këto organe.

Gjithashtu, duhet theksuar se ky argument nuk qëndron në të njëjtën linjë as me parashikimet e nenit 33 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet shprehimisht se Autoriteti Publik kryen një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjet e tij materiale (pra Ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar).

Bazuar në këtë kontroll të ushtruar, titullari i Autoritetit Publik përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, ku konstaton se, a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, (çka përbën dhe objektin e kërkesës për informim të ankuesit) të cilin ia paraqet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Bazuar në sa më sipër rezulton se Autoriteti Publik konsiderohet dhe duhet të veprojë si i tillë në kuptim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” edhe në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Rrjedhimisht vlerësohet se informacioni i hartuar nga Autoriteti Publik në përputhje me nenin 33 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*” dhe si i tillë duhet vënë në dispozicion të kërkuarit.

Sa i përket argumentit se Autoriteti Publik nuk e zotëron informacionin në formën e kërkuar nga ankuesi, Komisioneri vlerëson se interesi publik, që Neni A i Aneksit të



Kushtetutës dhe paragrafi 42 i Vendimit nr. 78 datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese i kanë atribuar procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve, (duke sanksionuar dhe përligjur edhe kufizimin e disa të drejtave themelore siç është e drejta për jetë private dhe familjare), detyron Autoritetin Publik, në kuadër të përmbushjes së qëllimit të këtij procesi (që siç përcakton neni 179/b i Kushtetutës dhe paragrafi 42 i Vendimit nr. 78, datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese është rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve), me qëllim garantimin e transparencës si një garanci dhe kusht parësor në përmbushjen e qëllimit të pasqyruar më sipër, të bëjë publik informacionin e kërkuar. Ky informacion mund të jetë qoftë në formën e kërkuar nga ankuesi apo edhe duke publikuar raportet individuale të hartuara në bazë të nenit 33 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, në funksion të përpunimit të tyre statistikor nga vetë ankuesi.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit ndaj Autoritetit Publik Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’.

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit me Nr. 1500 Prot., datë 16.11.2017, ndaj Autoritetit Publik “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave” me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit sipas objektit të kërkesës për informacion dhe më konkretisht: - *Cili është numri total i subjekteve të rivlerësimit që sipas vlerësimit të këtij institucioni ka rezultuar se:*
  - *Kanë deklaruar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare dhe nuk gjenden në situatë konflikt interesi;*
  - *Kanë patur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Deri në ç’nivele shkon pasuria që nuk justifikohet nga këto burime, Sa janë rastet kur ajo e tejkalon dyfishin e pasurisë së justifikuar nga subjekti si të ligjshme;*

- Kanë kryer fshehje të pasurisë? Nëse kanë rezultuar shkelje të tilla, të ç'natyre kanë qenë këto fshehje;
  - Kanë kryer deklaram të rreme? Nëse kanë rezultuar shkelje të tilla, ku kanë konsistuar këto deklarime të rreme;
  - Gjenden në situatën e konfliktit të interesit, i ç'natyre është ky konflikt, apo raportet individuale në tërësi, brenda datës 15.2 .2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
4. Ky vendim u shpall sot me datë 05.2 .2018.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

